



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 353/01-16037
Dt: 16.10.2024

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-463/01-11659 të datës 26.07.2024, duke u bazuar në nenin 19 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 12 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 42 dhe 44 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke vendosur lidhur me vlerësimin e ofertave të Njoftimit Publik me numër 01-353/01-14625 të datës 18.09.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës Lokalin me numra të parcelës P-70705029-00468-27, me sipërfaqe të prej 2215 m², së bashku me objektin – lokalin të quajtur “Blini” me numër të njësisë 468-26-599-0, me sipërfaqe të ndërtesës 169.4 m² Zona Kadastrale Gjakovë - Qytet, në mbledhjen e mbajtur me datën 15.10.2024, komisioni bie këtë:

V E N D I M

1. **ANULOHET** Njoftimi për Ankand Publik me numër 01-353/01-14625 të datës 18.09.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës Lokalin me numra të parcelës P-70705029-00468-27, me sipërfaqe të parcelës prej 2215 m², së bashku me objektin – lokalin të quajtur “Blini” me numër të njësisë 468-26-599-0, me sipërfaqe të ndërtesës 169.4 m² Zona Kadastrale Gjakovë - Qytet.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesja e Komisionit.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës përkatësisht Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01-463/01-11659 të datës 26.07.2024, në mbledhjen e mbajtur me datë 17.09.2024, kishte nxjerrë vendim për shpalljen e njoftimit për ankand publik numër 01-353/01-14625 të datës 18.09.2024, në ankandin publik ishin përcaktuar kushtet e veçanta dhe kushtet e përgjithshme.

Ankandi publik ka qenë i hapur nga data 18.09.2024 deri me datë 02.10.2024, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, në këtë procedurë kanë marrë pjesë gjithsej katër (4) ofertues.

Komisioni në prezencë të dy ofertuesve ka bërë hapjen e ofertave me datë 07.10.2024, ndërsa në mbledhjen e mbajtur me datë 15.10.2024, në shqyrtimin e dokumentacioneve të dorëzuara në ofertë sipas kushteve të njoftimit për ankand publik, komisioni konstatoi si vijon:

Ofertuesi me çmimin më të lartë në këtë njoftim, në ofertë ka dorëzuar “Dokumentin që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë lëshuar nga Gjykata Themelore, për pronarin e biznesit por jo edhe për përfaqësuesin e biznesit, siç është kërkuar në Njoftimin për Ankand Publik tek kushtet e përgjithshme.

Komisioni ka kërkuar të dhëna nga Sektori i Tatimit në Pronë të Komunës së Gjakovës lidhur me detyrimet e papaguara për ofertuesit. Nga evidencat e tatimit në pronë vërtetohet se ofertuesi me çmimin më të lartë në ankand ka detyrime të papaguara, rrjedhimisht bie ndesh me kushtet e përgjithshme të paracaktuara në ankand, po ashtu në evidencat e zyrës për regjistrimin e biznesit vërtetohet se me datë 02.10.2024, ofertuesi kishte ndryshuar aktivitetin kryesor që bie ndesh shkronjën (c) të kushteve të veçanta të Ankandit Publik, që aktiviteti kryesor të jetë në fushën e gastronomisë, kjo evidentohet edhe në listën e pagave të ofertuesit të lëshuar nga ATK-ja.

Komisioni brenda afateve ligjore do të bëjë rishpalljen e ankandit publik për këtë pronë të Komunës së Gjakovës.

Andaj, nga si u tha me lartë me shumicë votash u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Palët e pakënaqura me vlerësimin e komisionit, kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë pranë “Komisionit për ankesa” në afat prej shtatë (7) ditësh prej ditës së pranimit të vendimit.



Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Palës
- Arkivit.